AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# KOMUNIKATË PËR MEDIA

**Anketa e Statistikave të Investimeve në Ndërmarrje, 2022**

17.11.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Statistikave të Investimeve në Ndërmarrje për vitin 2022.

## Investimet më të mëdha në ndërtim në 2022

Sipas rezultateve në nivel vendi, gjatë vitit 2022, vlera e investimeve në ndërmarrje ishte 1 136 988 425 €. Investimet në ndërtim zënë pjesën kryesore të investimeve me 53,0%. Investimet e tjera që zënë një peshë të konsiderueshme janë ato në makineri dhe pajisje me 42,7%, ndërsa investimet e tjera me një peshë më të vogël në kuadrin e totalit të investimeve janë: investimet në asete të prekshme me rreth 3,7%; investimet në produktet e pronësisë intelektuale me 0,4%; si dhe investimet biologjike të kultivuara dhe serrat në bujqësi me rreth 0,1%.

**Investimet sipas kategorive, 2022 në (%)**




### Investimet sipas aktivitetit ekonomik

Aktivitetet me më së shumti investime ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë (26,8%); Ndërtimtaria (25,2%); Prodhimi (15,8%).

**Investimet sipas aktivitetit ekonomik, 2022 në (%)**




## Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve

Në vitin 2022, përqindja më e madhe e investimeve të ndërmarrjeve kosovare ishte te Ndërtimi, Pajisjet dhe Makineritë me mbi 90,0%. Ndërkaq, përqindja më e madhe e investimeve në vend nga ndërmarrjet e vogla (10 - 49 punëtorë) me 44,4%; ndërmarrjet e mesme (50 - 249 punëtorë) me 24,3%; dhe mini ndërmarrjet (1-9 punëtorë) me 22,7%.

**Investimet sipas madhësisë së ndërmarrjeve, (%)**



## Investimet sipas rajoneve

Sipas rezultateve në nivel vendi, në vitin 2022, përqindja më e lartë e investimeve të ndërmarrjeve sipas rajoneve ishte në: Prishtinë (49,9%); Prizren (11,3%); Mitrovicë (9,9%); Gjilan (8,9%); Pejë (7,4%); Ferizaj (6,7%); dhe Gjakovë (6,0%).

**Investimet sipas regjioneve dhe kategorisë së investimeve, (%)**




## Blerjet e reja, të importuara dhe investimet në vijim

Në kuadrin e blerjeve të reja investive prin: Ndërtimtaria (28,3%); Tregtia me shumicë dhe pakicë (24,2%); Prodhimi (16,1%); Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar (10,6%). Kurse sektorët e tjerë kanë përqindje më të ulët.

Sektorët që prijnë në blerje të importuara ishin: Prodhimi (24,7%); Tregtia me shumicë dhe pakicë (23,1%); dhe Informacioni dhe komunikimi (17,1%). Kurse sektorët e tjerë kanë përqindje më të ulët.

Te blerjet investive në vijim prin: Tregtia me shumicë dhe pakicë (46,6%); Ndërtimtaria (24,4%); Aktivitetet e patundshmerisë (7,9%); dhe Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (7,8%). Kurse sektorët e tjerë kanë përqindje më të ulët.

## Burimet e mjeteve për financimin e investimeve

Sa i përket burimit të investimeve, rreth 50,6% e vlerës së investimeve të ndërmarrjeve ishte realizuar nga fondet e veta; dhe 35,1% nga bankat vendore. Ndërkaq, burimet e tjera zënë një peshë më të vogël në kuadrin e burimeve totale për investime.

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

**Burimet e investimeve, (%)**

| Burimet e investimeve | Investimet 2021 | Investimet 2022 |
|---|---|---|
| Nga fondet e veta | 61,99 | 50,61 |
| Me bashkë-investitorët vendas | 1,00 | 2,61 |
| Me bashkë-investitorë të huaj | 0,91 | 6,00 |
| Nga bankat vendore | 30,42 | 35,08 |
| Nga kreditorët e huaj | 1,58 | 0,33 |
| Përmes leasing-ut financiar gjatë vitit 2022 | 0,75 | 1,00 |
| Nëpërmjet një ujdie (kompensimi) në vitin 2022 | 0,34 | 1,56 |
| Huazim ose borxh si (llogari të pagueshme) | 2,10 | 1,84 |
| Nga fondet e qeverisë qëndrore dhe lokale | 0,66 | 0,43 |
| Tjetër | 0,25 | 0,55 |
| **Gjithsej** | **100,0** | **100,0** |

Për më shumë informata lidhur me Anketën e Statistikave të Investimeve në Ndërmarrje për vitin 2022, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Investment